



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Nr. 7623/3029/861 Regj. Them.

Datë 01.10.2014 regjistrimi

Nr. 1214 Vendimi

Datë 18.05.2016

V E N D I M

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata Administrative e Apelit e përbërë nga:

GJYQTAR : Kastriot SELITA

GJYQTARE : Altina NASUFI

GJYQTARE: Bernina KONDI

-asistuar nga sekretare gjyqësore Raimonda Aliaj, në Tiranë në datë 18.05.2016 mori në shqyrtim në dhomë këshilli, çështjen administrative me palë ndërgjyqëse:

PADITËS :

Shoqëria “Ledi” shpk, me NIPT K76315291S, me seli në Babicë, Vlorë, përfaqësuar nga administratori Alfred Rrapaj.

TË PADITUR :

Drejtoria Rajonale e Tatimeve, Vlorë, me adresë në Lagja “Hajro Çakërrri”, rruga “Sheh Zeneli”, Vlorë.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria Juridike, Tiranë, me adresë në Rruga “Gjin Bue Shpata”, ish godina e maternitetit.

OBJEKTI :

Anullimi i aktit administrativ me nr. 5994, datë 30.05.2012 "Njoftim vlerësimi për detyrimet" për shumën 100.000 lekë që i referohet periudhës 2012/05.

Shfuqizimin e vendimit me nr.14195/1, datë 11.07.2012 të Drejtorisë së Apelit të Tatimit Tiranë.

BAZA LIGJORE:

Neni 324, 325 i Kodit të Proçedurës Civile Kreu XII "Ankimi administrativ tatimor", neni 116 e vijues i ligjit me nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për proçedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë".

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë me vendimin nr. 3018, datë 01.11.2012 ka vendosur:

- Pranimin e kërkesë padisë.
- Anullimin e aktit administrativ Njoftim Vlerësimi Tatimor Nr. 5994, datë 30.05.2012 lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë.
- Anullimin aktit administrativ Vendim Nr. 14195/1, datë 11.07.2012 lëshuar nga Drejtoria e Apelit të Tatimit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.
- Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës së paditur.
- Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 15 ditëve në Gjykatën e Apelit Vlorë, duke filluar nga e nesërmja e shpalljes së këtij vendimi.

Kundër këtij vendimi në datë 13.11.2012 ka paraqitur ankim pala e paditur (zënie afati) duke kërkuar ndryshimin e Vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe vendosur rrëzimin e padisë si të pambështetur në prova dhe në ligj

Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. 956 datë 29.05.2014 ka vendosur:

- Shpalljen e moskompetencës së Gjykatës së apelit Vlorë për gjykimin e çështjes civile me nr. 1497, datë 15.01.2013 dhe dërgimin e akteve për kompetencë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

në dhomë këshillimi, pasi dëgjoji relatimin e gjyqtares Altina Nasufi, shqyrtoi të gjitha aktet shkresore dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N

I.Rrethanat e çështjes:

1. Pala paditëse Shoqëria "Ledi" sh.p.k., ushtron aktivitet tregtar. Nga inspektorët e Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë, është ushtruar kontroll në Shoqërinë "Ledi" shpk Vlorë, në bazë të urdhërit të punës nr. 5480 ku është mbajtur akt konstatimi me nr. serie 0256507, i datës 23.05.2012 pasi u konstatua se subjekti me veprimtari ekonomike minimarket në lagjen "Pavarësia" Vlorë kryen aktivitet pa u pajisur me kasë fiskale dhe është nxjerrë Njoftim vlerësimi për detyrimet nr. 5994 prot, datë 30.05.2012 i Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë, ku është ngarkuar në total me detyrimin 100.000 lekë i cili përfshin gjobë, tatim, kamatvonesë për shkak të verifikimit në terren për mospajisje me kasë fiskale në adresën me nipt sekondar Lagja "Pavarësia" ~~X~~ Pala paditëse ka pretenduar se në datë 31.08.2009 ka lidhur kontratë furnizimi me shoqërinë "Albanian Electronics Distribution" lidhur me blerjen e tre kasave 2 Nesso, dhe 1 ZIP EJ; deklaratë e vendosjes në punë të regjistruarit elektronik fiskal pranë zyrës së Degës së Tatim Taksave Vlorë e datës 19.11.2009, datë 27.01.2010.

1.1 Kundër aktit të mësipërm, paditësi ka bërë ankimin administrativ në Drejtorinë e Apelimit Tatimor në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, (sipas dëftesës për pranimin e objekteve postare me kod-bar 000363505, është dërguar ankimi më datë 30.06.2012) e cila me Vendimin nr. 14195/1 prot, datë 11.07.2012 ka vendosur: *Të refuzojë ankimin për shkak se konsideron ankimin të papanueshëm pasi ka kaluar afati i ankimit tatimor. Kundër këtij vendimi, në zbatim të nenit 109 të Ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në RSH-së", lejohet ankim në gjykatë brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni."*

2. Paditësi duke mos qenë dakort me këto akte i është drejtuar gjykatës me padinë objekt gjykimi duke pretenduar se Njoftimi i Vlerësimit për Detyrimet Nr. 5994, datë 30.05.2012 lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë është në kundërshtim me ligjin. Kjo gjobë është vendosur

krejtësisht me motive abuzive, pasi paditësi ka aktivitet kryesor në Babiçë-Vlorë dhe ka tre adresa sekondare si më poshtë shënuar të cilat i ka të pajisura me kasa fiskale:

-Magazinë në lagjen "Pavarësia" (pranë zjarrfikësit) me numër serial-E010000458, i vendosur që prej datës 19.11.2009.

-Furgoni me targë VL 0705 C me nr.serial AEO 20000118, i vendosur që prej datës 27.01.2010.

-Furgoni me targa VL 3314 B me nr.serial AEO 20000246 i vendosur që prej datës 27.01.2010.

2.1 Paditësi e ka kundërshtuar këtë akt-veprimi të përfaqësuesve të punonjësve të Drejtorisë Tatimore Vlorë, pasi është person i cili asnjëherë nuk ka kryer veprimtari pa kasë fiskale sepse i ka vendosur ato në punë menjëherë sapo ka dalë ligji dhe këtë e vërteton me fletë raporteve tatimore ku pasqyrohen të dhëna se në nr.e NIPT-it që pretendohet prej palës së paditur që nuk ka kasë fiskale po me atë datë 23.05.2012 dhe me atë nr. NIPT K76315291S është lëshuar kupon tatimor. Ky lloj kuponi tatimor lëshohet nëpërmjet rregjistrit elektronik/kasë fikale. Gjithashtu nuk rezulton që të ketë të punësuar një punonjës me atë emër i cili ka refuzuar firmosjen e aktit.

2.2 Paditësi disponon deklaratën e vendosjes në punë të rregjistrit elektronik konkretisht të datës 19.11.2009 dhe datë 27.01.2010 dhe njëkohësisht kontratën e furnizimit me të treja kasat fiskale (dy me bateri dhe një statike).

2.3 Paditësi kundërshton edhe Vendimin nr. 14195/1, datë 11.07.2012 lëshuar nga Drejtoria e Apelit Tatimor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, pasi nga ky organ administrativ nuk është marrë në konsideratë fakti se shoqëria paditëse e ka ankimuar njoftimin e vlerësimit në kohën që është marrë dijëni. Mirëpo Drejtoria e Apelit Tatimor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve në kundërshtim me provat e paraqitura nga pala paditëse ka refuzuar ankimin e palës paditëse për shkak se e ka konsideruar ankimimin të papranueshëm pasi ka kaluar afati ankimimit tatimor.

3. Pala e paditur, ka prapsuar pretendimet e paditësit mbi këto argumente kryesorë mbështetës:

3.1 Administrata tatimore ka ndjekur të gjithë procedurën që parashikon Ligji 9920/2008 "Pë Proçedurat Tatimore". Inspektorët kanë ushtruar kontroll pranë shoqërisë paditëse dhe aty kanë konstatuar se kjo shoqëri ushtron aktivitet pa vendosur kasë fiskale.

3.2 Në kushtet kur paditësi nuk ka ezauruar procedurën administrative sepse ka qenë jashtë afatit ligjor të ankmit dhe nuk ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës për shqyrtimin e kësaj çështje. Pretendimet e paditësit për instalimin e kasës fiskale është një detyrim ligjor dhe për rrjedhojë kjo padi nuk duhet të pranohet.

II. Vlerësimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë:

4. Gjykata ka pranuar padinë me këtë arsyetim ligjor:

4.1 Nga Akt Konstatimi (pa numër.) datë 23.05.2012 mbajtur nga Inspektorët e Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë rezulton se ato kanë ushtruar një kontroll në një minimarket, lagja "Pavarësia"-Vlorë. Mbas këtij kontrolli ato kanë konstatuar se në këtë subjekt janë gjetur shkelje të Ligjit 9920/2008 "Për Procedurat Tatimore". Ka rezultuar se në këtë subjekt në momentin e kontrollit nuk ekziston kasë fiskale. Për këtë arsye pala paditëse është gjobitur në shumën 100.000 lekë. Nga Njoftimi i Vlerësimit për Detyrimet nr. 5994, datë 30.05.2012 lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë rezulton se DRT Tiranë ka njoftuar palën paditëse për detyrimet tatimore në zbatim të kërkesave të Ligjit 9920/2008 "Për Procedurat Tatimore". Ky detyrim është i përbërë nga gjobat që inspektorët e palës së paditur DRT Tiranë kanë vendosur gjobë për mospajisje me kasë fiskale në shumën 100.000 lekë.

4.2 Nga Vendimi nr. 14195/1, datë 11.07.2012 i Drejtorisë së Apelit Tatimor pranë Drejtorisë së Përgjithshme së Tatimeve rezulton se ky organ apelimi administrativ ka lënë në fuqi Njoftimin e Vlerësimit për Detyrimet nr. 5994, datë 30.05.2012 lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë. Nga administrimi në seancë gjyqësore i provave të paraqitura nga pala paditëse vërtetohet plotësisht se paditësi ushtron aktivitet tregëtar me "tregëti të ndryshme" dhe është i pajisur me tre kasa fiskale. Pretendimi i palës së paditur se paditësi nuk ka patur kasë fiskale të instaluar në kontrollin e datës 23.05.2012 rrëzohet me argumentin/provën se po atë ditë ka lëshuar kupon tatimor nëpërmjet kasës fiskale elektronike dhe me nr. NIPT K76315291S (shih raport tatimor dy faqe e administruar në proces).

4.3 Inspektorët e palës së paditur kanë plotësuar një akt konstatimi pa pasqyruar gjendjen faktike, duke e bërë aktin të pavërtetë, në shkelje të parimit të vërtetësisë dhe të paanësisë, parashikuar

nga neni 12 i K.Pr.Administrative, detyrim i cili duhet të udhëheqi në punën e saj administratën publike për të trajtuar në mënyrë të ndershme dhe të paanshme të gjitha objektet mbi të cilat hyn në marrëdhënie. Në këtë rast është përpiluar një akt konstatimi dhe më pas është lëshuar Njoftim i Vlerësimit të Detyrimeve Tatimore. Mirëpo pretendime të tilla nuk mund të lihen vetëm në kuadrin e hartimit të një akti, por edhe duhet provuar në formë të plotë shkresore. Çështja e mospajisjes me kasë fiskale është një pretendim që nuk provohet nga pala e paditur. Nga kupon tatimor nëpërmjet kasës fiskale elektronike dhe me nr. NIPT K76315291S rezulton se kjo shoqëri ka kryer aktivitetin e saj tregtar sipas legjislacionit fiskal duke lëshuar kupona tatimore. Inspektorët e palës së paditur nuk kanë paraqitur asnjë provë për të vërtetuar këtë pretendim. Kjo mënyrë konstatimi tejkalon procedurat normale të kontrollit ligjor sipas legjislacionit përkatës. Kjo formë kontrolli shkon drejt abuzimit dhe arbitraritetit. Pala e paditur nuk mund të bëjë kontrolle të tilla pa u prezantuar në mënyrë formale dhe pa kërkuar personin e autorizuar të objektit të kontrolluar.

4.4 Nga të gjitha këto akte shkresore me vlerë të plotë provuese rezulton se shoqëria "Ledi" sh.p.k ka dokumentuar në përputhje me legjislacioni përkatës të gjithë aktivitetin e saj. Pala e paditur pa të drejtë dhe pa dhënë asnjë argument bindës e ka konsideruar këtë fakt të paplotë si shkelje administrative dhe ka llogaritur një detyrim financiar të padrejtë ndaj kësaj shoqërie. Inspektorët pa u informuar në mënyrë të plotë dhe përfundimtare kanë vendosur për të gjobitur palën paditëse. Pretendimet e palës së paditur në lidhje me mospajisje me kasë fiskale të paditësit nuk janë provuar në asnjë moment gjatë procesit gjyqësor. Nga akti i konstatimit rezultojnë pasaktësi të dukshme. Nuk vërtetohet në asnjë moment nëse shoqëria paditëse ka kryer shitje dhe këto shitje realizoheshin pa lëshuar kupon tatimor nëpërmjet kasës fiskale. Pavarësisht shënimeve përkatëse të inspektorëve në aktin e konstatimit, në këtë akt nuk janë hedhur në mënyrë të plotë dhe korrekte shkeljet e mundshme të gjetura tek shoqëria paditëse, saqë krijon bindjen se akti është plotësuar jo në formën dhe mënyrën e përcaktuar nga ligji. Çdo kundërvajtje administrative duhet të evidentohet e të provohet në mënyrë të plotë.

4.5 Gjithashtu gjykata konstaton një shkelje të procedurave ligjore për shqyrtimin e ankimimit administrativ që shoqëria paditëse ka paraqitur pranë Drejtorisë së Apelit Tatimor. Kjo drejtori pa të drejtë ka refuzuar të marrë në shqyrtim Njoftimin e Vlerësimit për Detyrimet Nr. 5994, datë

30.05.2012 lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë. I gjithë argumenti i këtij organi apelimi administrativ është sepse shoqëria paditëse ka qenë në kapërcim të afateve të ankimit administrativ. Pala paditëse është vënë në dijeni të Njoftimit të Vlerësimit për Detyrimet Nr. 5994, datë 30.05.2012 lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë dhe brenda afatit ligjor ka realizuar ankimin administrativ. Del plotësisht e vërtetuar se njoftimi për vlerësim detyrimi tatimor për subjektin "Ledi" sh.p.k është përpiluar më datë 30.05.2012, me nr. 5994 prot. Edhe sikur të jetë nisur po atë ditë me postë, do pak ditë të arrijë në vendbanimin e palës paditëse. Theksojmë pak ditë/evazive, pasi vetë ligji dhe akti ligjor në zbatim të tij : Udhëzimi me nr.24, datë 02.09.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" në nenin 69 të tij parashikon se...*Njoftimi i vlerësimit tatimor dërguar me postë rekomande në adresën e personit të tatueshëm, merret në konsideratë se është marrë nga ky i fundit 7 ditë pas datës së dorëzimit në shërbimin postar. Njoftimi i vlersimit tatimor hyn në fuqi,10 ditë kalendarike pasi ai të jetë marrë ose të konsiderohet se është marrë nga personi i tatueshëm....* Rezulton plotësisht e provuar se paditësi më datë 30.06.2012 ka nisur në rrugë postare ankimin pranë Drejtorisë së Apelit Tatimor pranë Drejtorisë së Përgjithshme së Tatimeve Tiranë. Pra pala paditëse është plotësisht brenda afatit ligjor të ankimit administrativ për rastin konkret. Në raste të tilla pala e paditur duhet të zhvillojë një proces administrativ të plotë duke llogaritur afatin e lindjes së drejtës ankimore dhe jo të refuzojë marrjen në shqyrtim të pretendimeve të palës ankimuese.

III.Shkaqet e ngritura në ankimin e palës së paditur

6. Pala e paditur ka kërkuar ndryshimin e Vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, rrëzimin e padisë si të pambështetur në prova dhe në ligj për këto shkaqe:

6.1 Inspektorët e verifikimit në terren të DRT Vlorë në zbatim të detyrave të tyre funksionale gjate kontrollit të ushtruar në subjektin Ledi sh.p.k kanë mbajtur akt konstatimin e datës 23.05.2012 në bazë të urdhrit të punës nr.5480 ku u kostatua se subjekti "Ledi" shpk me veprimtari ekonomike minimarket në lagjen Pavarësia Vlorë kryen aktivitet pa u pajisur me kasë fiskale.

6.2 Mbi bazën e këtij akt konstatimi ka dalë dhe Njoftim vlerësimi për detyrimet në masën 100.000 lekë. Këtë Njoftim Vlersimi paditësi e ka ankimuar në Drejtorinë e Apelit Tatimor Tiranë jashtë afatit e cila me të drejtë ka vendosur refuzimin pasi ka kaluar afati i ankimit

tatimor. Në këto kushte kur paditësi nuk ka ezauruar procedurën administrative, ai e humbet të drejtën për t'ju drejtuar gjykatës për shqyrtimin e kësaj çështje.

6.3 Për sa i përket themelit të çështjes, pretendimet e paditësit se veprimet e administratës tatimore janë në kundërshtim me ligjin nuk qëndrojnë pasi detyrimi për të instaluar dhe përdorur pajisjet fiskale përcaktohet qartë në ligjin 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” nën 55 Detyrimi për përdorimin e pajisjeve fiskale.

IV. Vlerësimi i Gjykatës Administrative të Apelit:

7. Gjykata kryesisht konstatoi se çështja përbën lëndë juridiksioni gjyqësor dhe se ajo ka kompetencën lëndore dhe funksionale të gjykimit të saj bazuar në nenet 7 dhe 10 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar dhe duke iu referuar për zbatim Vendimit Njehsues Administrativ të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë me nr. 3, datë 06.12.2013.

8. Në lidhje me kushtet e pranueshmërisë së ankimit, Gjykata e Apelit konstaton se ankimi është paraqitur brenda afatit ligjor, në formën e duhur procedurale, para gjykatës kompetente, nga subjekti i legjitimuar pasivisht në padi, legjitimuar edhe në të drejtën e ankimit sipas përcaktimeve të nenit 452 e vijues të Kodit të Procedurës Civile.

9. Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se në kufijtë e shqyrtimit të çështjes sipas nenit 37/1 të ligjit nr.49.2012, ajo shqyrton ligjshmërinë e veprimit administrativ në bazë të provave të paraqitura nga palët dhe situatës ligjore dhe faktike që ekzistonte në kohën e kryerjes së veprimit konkret administrativ. Në kohën e nxjerrjes së aktit administrativ objekt gjykimi: njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore nr.51008/1 prot, datë 26.09.2011, neni 122 i ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar kishte këtë përmbajtje:

“Tatimpaguesi, person juridik ose fizik tregtar dënohet në rast se

a-.....

b- nuk lëshon kuponin tatimor për qarkullimin e realizuar të mallrave apo të shërbimeve, për çdo rast konstatimi;

i)për kontrollin e parë, me gjobë në masën 200 000 (dyqind mijë) lekë, për tatimpaguesit e regjistruar si subjekte të tatimit mbi vlerën e shtuar dhe tatimit mbi fitimin, dhe gjobën, në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë, për tatimpaguesit e tjerë;

ii)për kontrollin e dytë, me gjobë në masën 300 000 (treqind mijë) lekë, për tatimpaguesit e regjistruar si subjekte të tatimit mbi vlerën e shtuar dhe tatimit mbi fitimin dhe gjobën në masën 200 000(dyqind mijë) lekë për tatimpaguesit e tjerë.

iii) për kontrollin e tretë me gjobë në masën 500 000 (pesëqind mijë) lekë ose me mbyllje të veprimtarisë deri në 6(gjashtë) muaj;

10. Në udhëzimin me nr.24 datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në RSH-së”, në kreun VI, pika 55 e tij është parashikuar se :

‘55. Detyrimi për përdorimin e pajisjeve fiskale.

Personat e tatueshëm, subjekte të tatimit mbi vlerën e shtuar apo të tatimit mbi fitimin dhe personat e tatueshëm, subjekte të taksës vendore mbi biznesin e vogël dhe tatimit mbi të ardhurat, janë të detyruar të pajisen, të përdorin dhe mirëmbajnë pajisjet fiskale në përputhje me dispozitat e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 781, datë 14.11.2007 "Për karakteristikat teknike e funksionale të pajisjeve fiskale, sistemit të integruar të kompjuterizuar për transferimet periodike, automatike të deklarimeve financiare, sistemit të komunikimit për procedurën e dokumentacionin për miratimin e tyre dhe për kriteret për pajisjen me autorizim të shoqërive të autorizuarra për ofrimin e pajisjeve fiskale" dhe akteve të tjera nënligjore në zbatim të tij”.

11. Zhvillimi i gjykimit në shkallë të parë ka vërtetuar se Inspektorët e Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë kanë ushtruar një kontroll në një minimarket, lagja "Pavarësia"-Vlorë. Mbas këtij kontrolli ato kanë konstatuar se në këtë subjekt janë gjetur shkelje të Ligjit 9920/2008 "Për Proçedurat Tatimore", pasi në këtë subjekt në momentin e kontrollit nuk ekzistonte kasë fiskale dhe për këtë arsye pala paditëse është gjobitur në shumën 100.000 lekë. Nga Njoftimi i Vlerësimit për Detyrimet Nr. 5994, datë 30.05.2012 lëshuar Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë rezulton se DRT Tiranë ka njoftuar palën paditëse për detyrimet tatimore në zbatim të kërkesave të Ligjit 9920/2009 "Për Proçedurat Tatimore", detyrim i përbërë nga gjobat që inspektorët e

palës së paditur DRT Tiranë kanë vendosur gjobë për mospajisje me kasë fiskale në shumën 100.000 lekë.

12. Një nga risitë që ka sjellë hyrja në fuqi e ligjit nr.49/2012 është ndryshimi në koncept i parimit procedural të barrës së provës që në gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative i ka kaluar organit të administratës publike, i cili si rregull ka detyrimin të provojë bazueshmërinë në ligj dhe në fakt të veprimeve të kryera prej tij¹. Ky parim ka gjetur sanksionim edhe në nenin 35 të ligjit, dispozitë sipas të cilës organi publik ka detyrimin të provojë ligjshmërinë e aktit administrativ, të nxjerrë jo me kërkesë të paditësit. Akti administrativ objekt gjykimi: Njoftimi i Vlerësimit për Detyrimet Nr. 5994, datë 30.05.2012 lëshuar Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë është një akt i nxjerrë *ex officio*, në kuadrin e ushtrimit të veprimtarisë shtetërore të palës së paditur pa kërkesë nga pala paditëse. Inspektorët e palës së paditur kanë plotësuar një akt konstatimi pa pasqyruar gjendjen faktike, duke e bërë aktin të pavërtetë, në shkelje të parimit të vërtetësisë dhe të paanësisë, parashikuar nga neni 12 i K.Pr.Administrative, siç me të drejtë ka konstatuar gjykata e shkallës së parë pasi kjo palë nuk paraqiti prova që të vërtetojë se përveç akt-konstatimit të datës 23.05.2012 të jenë konstatuar edhe raste të tjera të mospajisjes së klientëve me kupon tatimor. Ky pretendim me të drejtë nga kjo gjykatës rrëzohet me argumentin/provën se po atë ditë paditësi ka lëshuar kupon tatimor nëpërmjet kasës fiskale elektronike dhe me nr. NIPT K76315291S.

13. Gjykata e apelit çmon se me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka konstatuar një shkelje të procedurave ligjore për shqyrtimin e ankimit administrativ që shoqëria paditëse ka paraqitur pranë Drejtorisë së Apelimit Tatimor. Kjo drejtori pa të drejtë ka refuzuar të marrë në shqyrtim Njoftimin e Vlerësimit për Detyrimet Nr. 5994, datë 30.05.2012 lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë. I gjithë argumenti i këtij organi apelimi administrativ është sepse shoqëria paditëse ka qenë në kapërcim të afateve të ankimit administrativ. Pala paditëse është vënë në dijeni të Njoftimit të Vlerësimit për Detyrimet Nr. 5994, datë 30.05.2012 lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë dhe brenda afatit ligjor ka realizuar ankimin administrativ. Del plotësisht e vërtetuar se njoftimi për vlerësim detyrimi tatimor për subjektin "Ledi" sh.p.k është përpiluar më datë 30.05.2012, me nr. 5994 prot. Rezulton plotësisht e provuar se paditësi më datë

¹ Neni 3, pika 3 e ligjit nr.49, datë 03.05.2012.

30.06.2012 ka nisur në rrugë postare ankimin pranë Drejtorisë së Apelit Tatimor pranë Drejtorisë së Përgjithshme së Tatimeve Tiranë. Pra pala paditëse është plotësisht brenda afatit ligjor të ankimit administrativ për rastin konkret.

14. Për të gjitha arsyet e lartëcituara, Gjykata çmon se aktet administrative objekt gjykimi Njoftimi i Vlerësimit për Detyrimet Nr. 5994, datë 30.05.2012 lëshuar Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë është një akt i nxjerrë në kundërshtim me ligjin dhe për rrjedhojë i tillë është edhe Vendimi Nr. 14195/1, datë 11.07.2012 lëshuar nga Drejtoria e Apelit Tatimor pranë Drejtorisë së Përgjithshme së Tatimeve që e ka lënë në fuqi atë. Gjykata Administrative e Apelit konkludon se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, është marrë në interpretim të drejtë të ligjit në raport me faktet objekt shqyrtimi gjyqësor dhe provat shkresore.

15. Lidhur me pretendimet e parashtruara në ankim, referuar fakteve të mësipërme, Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se janë të pabazuara në ligj e prova. Në këto pretendime rezulton të jenë paraqitur të njëjtat fakte dhe argumenta që janë paraqitur edhe gjatë gjykimit të çështjes në shkallë të parë dhe asnjë argument shtesë përse analiza e rrethanave të faktit të bërë në vendimin e gjykatës së shkallës së parë është e pabazuar në ligj e prova. Edhe procedura e zhvillimit të këtij gjykimi rezulton të jete në perputhje të plote me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile. Nuk konstatohen shkelje si në procedurën e zhvillimit të gjykimit edhe në procedurën e marrjes së vendimit nga gjykata e shkallës së parë.

16. Për të gjitha arsyet e lartërenditura Gjykata e Apelit nuk gjen shkaqe ligjore për të cënuar vendimmarrjen e gjykatës së shkallës së parë dhe për këtë arsye vendimi nr. 3018, datë 01.11.2012 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë duhet lënë në fuqi sipas nenit 50, shkronja “b” e ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Administrative e Apelit, bazuar në nenin 50, shkronja “b” e ligjit nr.49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar

VENDOSI :

- Lënien në fuqi të vendimit nr. 3018, datë 01.11.2012.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.
- Kundër këtij vendimi lejohet rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë brenda 30 ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e njoftimit të këtij vendimi.

Tiranë, më 18.05.2016

GJYQTARE

Bernina KONDI

d.v

GJYQTARE

Altina NASUFI

d.v

GJYQTAR

Kastriot SELITA

d.v

Vertetohet njësia me origjinalin

*Kancelari
Leonard Steboj
Steboj*